



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 569 Prot.

Ballsh, më 14 . 11 .2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 42 Datë 14/11 2025

PËR
SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2026

Në zbatim të Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligji 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

Të miratoj:

1. Paketën fiskale për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026.

Në bashkëpunim me ju!

Drejtori Drejtorise Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale
Aleksander Rama

KRYETAR
Qerim ISMAILOVAJ





BASHKIA MALLAKASTËR



DRAFT

PAKETA FISKALE

TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

VITI 2026

- **RRETH BASHKISË MALLAKASTËR**

Zona e Mallakastres ka nje histori te lashte te zhvillimit dhe qyteterimit qe daton rreth vitit 280 p.K me Mbretin Monuni. Krahina e Mallakastres eshte shume e pasur nga pikepamja arkeologjike, ku zbulime te ndryshme deshmojne per zhvillimin e qytetit te Gurëzezës, zona e Cakranit, si qender e nje dinastie te tre mbreterve dhe qytetin Bylis, nje nga qendrat me te pasura te Mbreterise Ilire.



Bashkia Mallakaster eshte pjese integrale e territorit dhe administrimit te Qarkut Fier, nje nga gjashte Bashkite e reja e krijuar me Ligjin mbi ndarjen e re territoriale dhe administrative ,e cila kufizohet ne veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me bashkitë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit. Territori i Bashkise shtrihet ne nje zone kodrinore ne jug te Ultesires Perendimore Panadriatike dhe sherben si nje zone kalimtare midis kesaj te fundit dhe Krahines Malore Jugore¹, me lartesi mbizoteruese 200 deri 300 metra mbi nivelin e detit. Pika me e larte e krahines eshte maja e Shëndëllisë (712 metra).

Siperfaqja e Bashkise Mallakaster eshte 329.19 km² Sipas CENSUS të vitit 2023, bashkia numëron **15 838** banorë ndërkohë që sipas RGJC 2024 ka një popullsi prej **39 118** banorë, dhe densitet prej 118.83 banorë/km². Kryeqendra e Bashkise eshte Qyteti i Ballshit qe shtrihet ne luginen e Gjanices dhe pergjate rruges kombetare Fier-Gjirokaster (siperfaqe prej 130 ha). Zona e Ballshit eshte e pasur me rezerva te hidrokarbureve, zona industriale eshte zhvilluar ne pjesen veriore te qytetit, ndersa pjesa urbane eshte zhvilluar ne jug..

Sipas ligjit “Për ndarjen Adminirtativo-Territoriale” (nr.115/2014), Bashkia Mallakaster perbehet nga 9 njesi administrative. Bashkia administron qytetin e Ballshit dhe nje numer konsiderueshem fshattrash (43) te vendosura ne nje siperfaqe relativisht te madhe. Tabela 1 jep te dhena mbi njesite administrative e Bashkise, dhe elemente perberes te tyre (qytetin dhe fshatrat).

Tabela 1: Ndarja Administrative e Bashkise Mallakaster, 2015

Qarku Fier/ Bashkite	Nr. Bashkive	Bashkia	Njesi Administrative	Qytetet dhe Fshatrat ne perberje te tyre
Fier Patos Roskovec Lushnje Divjake Mallakaster	6	Mallakaster	Ballsh	Qyteti Ballsh
			Qender Dukas	Fshatrat: Visokë, Belishovë, Belishovë e Re, Drenovë, Drenovë Fushë, Drenovë, Kash, Usojë, Ngraçie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas
			Greshicë	Fshatrat: Greshicë, Greshicë e Re
			Aranitas	Fshatrat: Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen
			Hekal	Fshatrat: Hekal, Klos, Mollaj, Rromës
			Ngraçan	Fshatrat; Ngraçan, Riban
			Kutë	Fshatrat; Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçëm
			Fratar	Fshatrat; Bejar, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh
Selitë	Fshatrat; Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë			

Zona ka sipërfaqe të konsiderueshme me kullota dhe pyje dhe me pak tokë bujqesore (toke arë), vend të rëndësishëm zë fruktaria (kultivohen pemë si qershitë, dardha dhe fiq), vreshta dhe ullinjët. Bujqësia është sektori kryesor i ekonomisë lokale për punësimin. Sektor tjetër është industria e nxjerrjes së hidrokarbureve, me vendburimet e pasura që japin një kontribut në zhvillimin ekonomik të zonës dhe punësimin.

Sektor të tjerë të ekonomisë janë shërbimet, tregtia, ndërtimi, sektori bankar, dhe telekomunikacioni.

Aktivitetet ekonomike kryesore (me peshë me të madhe) në njesinë administrative Ballsh (qyteti) referuar numrit të të punësuarave janë shërbimet që zënë 39.1% të totalit dhe industria (36.4%). Aktivitete të tjera janë tregtia, ndërtimi dhe me pak bujqësia. Në Njesitë Administrative të tjera, aktiviteti kryesor është bujqësia dhe pyjet (përfshirë ullinje, vreshtat dhe fruktarine), që varion nga 58.5% në Fratar në 91.4% në Ngraçan.

Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Pas bashkimit të menjëhershëm të 9 (nëntë) njësisive të qeverisjes vendore, Bashkia Mallakastër u ballafaqua me nevojën e hartimit të një pakete fiskale të integruar dhe të aplikueshmenë të gjithë territorin.

Bashkia Mallakastër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të Integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksapaguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Bashkia Mallakastër është bashkia që vetë ka bërë të mundur:

- Studimin dhe aplikimin e niveleve të ndryshme të studiuara të taksave dhe tarifave vendore, në njësi të ndryshme, sipas tipologjisë dhe sipas ndarjes territoriale.
- Referencë dhe aplikim i duhur i bazës ligjore: Auditimet e kryera nga niveli qendror, ministria e Financave klasifikon Bashkinë Mallakastër ndër bashkitë që ka dhënë shembullin dhe eksperiencën pozitive për t'u bashkëndarë me bashkitë e tjera.
- Ka bërë analizën dhe planin e menaxhimit për shërbimet publike si:
 - Plani për menaxhimin mbetjeve të ngurta urbane,
 - Studim dhe analizë të kostove, të përditësuar vit pas viti, për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve,
 - Studim dhe analizë, të përditësuar vit pas viti, të kostove për shërbimin e ndriçimit rrugor në qytet dhe njësi administrative,
 - Analizë të kostos për shërbimin e gjelbërimit,
 - Planifikim dhe përmirësim të analizave të kostove për mirëmbajtjen në infrastrukturën rrugore dhe rrugë rurale,
 - Përmirësimin e diferencimit të taksimit, si dhe tarifimit sipas llojit të shërbimit, standartit, vendodhjes, etj.
 - Lehtësi për grupe të veçanta, përjashtime apo incentiva të nevojshme.
 - Përmirësim të shërbimit dhe përmirësim të dukshëm të treguesve të performancës të furnizimit me ujë të pijshëm.
 - Analizë të përmirësuar dhe planifikim për shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve të arsimit parashkollor, 9 – vjeçar dhe arsimit të mesëm.
 - Analizë të përmirësuar të kostove sipas standarteve për shërbimet publike: menaxhimi i mbetjeve, shërbimi i kullimit, gjelbërimi, ndriçimi rrugor, etj.
 - Bazë e të dhënave të plota për bizneset;
 - Bazë e të dhënave të përditësuar dhe përmirësuar për familjet dhe individët;
 - Standartizim të procedurave administrative të aplikueshme nga administrata vendore në të gjithë territorin.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe përditësimit të regjistrave të saktë elektronikë, të nevojshëm për llogaritjen e kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye i është kushtuar vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, janë ushtruar verifikime të vazhdueshmenë të gjitha njësive administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitallizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultateve shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesorë të të ardhurave.

Vëmendje dhe punë të vazhdueshme i kemi kushtuar përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj

Megjithë punën e bërë ka nevojë të vazhdohet puna për përmirësimin e të dhënave në sistemin e administrimit elektronik. Këto të dhëna lidhen kryesisht me:

- Plotësimin e bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Plotësimin e bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Plotësimin e bazës së të dhënave për hapësirën publike (territore të zëna me ndërtesa informale, objekte të tjera pronë publike, rrugë,sheshe, trotuare, çdo pronë tjetër publike)
- Hartimin e një plani për parkimin publik;

Për të arritur këto synime është e domosdoshmedhe vendimmarrëse bashkëpunimi dhe dhënia e informacionit të detyrueshëm nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës. Megjithë vështirësitë, Bashkia Mallakastër do të përpiqet të verifikojë hap pas hapi në territor përmes inspektimit dhe akteve të verifikimit, duke saktësuar kështu përditë të dhënat fiskale.

Grupi i punës:

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Mallakastër:

- Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale,
- Drejtoria e Shërbimeve Publike Mallakastër,
- Drejtoria e Administrimit,Zhvillimit të Territorit dhe Kadastrës,
- Drejtoria e Kulturës, Arsimit,Sportit,Turizmit dhe Shëndetësisë
- Drejtoria e IMT-së,MZSH-së dhe Policisë Bashkiake
- Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe AKU,
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore ,Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse,
- Sektori i Auditit të Brëndhsëm
- Z/Kryetarët,
- Administratori e njësisë administrative,
- Qendra Kulturore e Fëmijëve
- Drejtuesit e kopshteve dhe çerdheve

Procesi i hartimit të paketës fiskale të integruar

Ngritja e Grupit të përbashkët të punës për hartimin e paketës së integruar fiskale

Përcaktimi i bazës ligjore dhe dokumentave strategjike, që do të referohemi,

Vlerësimi i situatës dhe hartimi i propozimeve konkrete.

Konsultim i propozimeve të paketës fiskale me banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Finalizimi i procesit të hartimit të paketës fiskale dhe dërgimi për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkia Mallakastër janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në njësit administrative dhe në qytet sipas kalendarit të përcaktuar nga grupi i punës.

Çfarë prezanton paketa fiskale?

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore. Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zonë të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës.

Miradministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të të ardhurave si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave, zbatimi i ligjit përbën moton e punës tonë.

Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara.

Në synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuar në planin tonë strategjik më afatgjatë.

Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetëm në hartimin e politikës fiskale, por sidomos për zbatimin e saj.

Nga analiza e ecurisë së realizimit të të ardhurave të deritanishme rezulton se ka burime akoma të pashfrytëzuara në kapacitetet optimale. Kjo vërehet pothuaj në të gjitha njësitë administrative.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, ju paraqesim paketën fiskale me ndryshimet e propozuara. Propozimet janë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura. Ato konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, duke patur parasysh që paketa fiskale është e integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat Bashkia Mallakastër duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësisve për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
 - Taksim i drejtë;
 - Tarifim mbështetur në kosto;
 - Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit, vendndodhja.
 - Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja dhe shërbimet që ofrohen.

➤ **KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR**

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligje:

- Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*", T ë ardhurat vendore përfshihen kryesisht:
- Ligji nr 68/2017, "*Për financat e vetqeverisjes vendore*" i ndryshuar, si dhe udhëzimet në zbatim të tij, përbjnë bazën për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.
- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar

- Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar
- Ligji nr. 29 datë 30.03.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
- **Ligji nr.9723**, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar;
- **Ligji nr. 9920**, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- **Ligji nr. 152/2015**, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", i ndryshuar;
- **Ligji nr.10081**, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar";

• Vendime dhe udhëzime

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit";
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.607, date 29.07.2020 2020 "**Për tarifën e Shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi**".
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 "Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor";
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 08.09.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat";
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore";
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar;
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 "Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme";
- ✓ Udhëzimi nr.632 datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje",

- **Të ardhurat kryesore të Bashkisë vijnë nga:**
- **Taksa e pasurisë (taksë ndërtese, taksë tokë bujqësore, taksë trualli)**
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;**
- **Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;**
- **Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;**
- **Taksa e zënies së hapësirave publike;**
- **Taksa e tabelës/reklamati;**
- **Taksa të përkohshme;**
- **Tarifa për shërbime;**

ZBATIMI I SISTEMIT TATIMOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të ligjit nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4 i tij shprehet:

Bashkitë dhe organet tatimore i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyrues për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për aq sa këto të fundit nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe me ligjin "Për vetëqeverisjen vendore"

RREGULLA TË PËRBASHKËTA PËR TAKSAT VENDORE

Me përjashtim të të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

1. Bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;
2. Vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës.
3. Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;
4. Përcakton:
 - 4.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave;
 - 4.2 Mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta;
 - 4.3 Rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake, në mbështetje të administrimit të taksave vendore;
 - 4.4 Rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore;
 - 4.5 Kriteret dhe procedurat e mardhenieve me taksapaguesit, përfshirë të drejtën e tyre të ankimit;
 - 4.6 Mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative.

• TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas

përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Llojet e taksave vendore janë si më poshtë:

- a) taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
- b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
- ç) taksa e tabelës;
- d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
- dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
- e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
- ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

• TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA

Në zbatim të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore “ neni 25 i tij shprehet:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.

2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

- a) **97** për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
- b) **25** për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- c) **5** për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
- ç) **2** për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

Në mënyrë më të detajuar po e paraqesim si më poshtë e ndarë në:

1. Kapitulli I - Taksat vendore
2. Kapitulli II – Tarifat vendore
3. Kapitulli III - Penalitetet

Kapitulli I: Taksat vendore

I.TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

“Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Ne zbatim të ligjit nr. 68/2017 neni 12 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, **Për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 për qind dhe minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.**

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin
- Taksa mbi tokën bujqësore

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

1.1. TAKSA MBI NDËRTESEN

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind.

Në zbatim të VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar, çmimi mesatar referues për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për banesat ,për qytetin e Ballshit është 30.000 lekë.

Nr.	Kategoritë e objekteve	Taksa e ndikimit në infrastrukturë (%) qyteti Ballsh	Taksa e ndikimit në infrastrukturë (%) për Njësitë Administrative
1	Objekte për qëllime banimi	3 %	2 %
2	Objekte për qëllime shërbimi	3 %	3 %
3	Objekte për qëllime banimi dhe shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit	4 %	4 %
4	Objekte për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral si dhe objektet sportive sipas përcaktimeve në legjisllacionin për sportin	1 %	1 %
5	Objekte për prodhim industrial	3 %	3 %
6	Objekte me karakter fetar, bamirësie	1 %	1 %
7	Objekte turistike	2 %	2 %
8	Rikonstruksion objekti banimi	2%	2 %
9	Rikonstruksion objekti shërbimi, industrial, turistik etj.	3 %	3 %
10	Ndërtim muri rrethues (vlera e investimit)	1 %	1 %
11	Vendosje antenash	3 %	3 %
12	Objekte për përdorim publik	1 %	1 %
13	Projekte të infrastrukturës publike	0.1%	0.1%
14	Objekte për të cilët është marr vendimi për legalizim	0.5%	0.5%

Përfshirje:

- 1- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjisllacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*".
- 2- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "*agroturizëm*", sipas legjisllacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- 3- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen civile

Vetëdeklarimi

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.

Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjisllacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim

e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

- a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JOBANIMI

- a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.
- b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.
- ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.
Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.
- d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

Pagimi i kësaj takse do të kryhet nëpërmjet Shoqërisë së Ujësjellës Kanalizime sh.a Fier aty ku ofrohet shërbimi nëpërmjet faturës elektronike,dhe pjesa tjetër do ta paguaj sipas faturës për arkëtim që do të lëshohet nga sektori i Tatim Taksave të Bashkisë Mallakastër.

Sektori që mbulon dhe rakordon me Shoqërisë së Ujësjellës Kanalizime sh.a Fier për arkëtimin e detyrimit të Taksës së ndërtesës është Sektori i Tatim Taksave .

1.2. Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës **31 dhjetor** të vitit fiskal. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Taksa mbi tokën bujqësore propozohet që të jetë me nivel takse të unifikuar sipas njësisive administrative ,duke patur parasysh dhe strukturën e tokave që kanë këto njësi.

Niveli i taksës së tokës bujqësore u vendos sipas nivelit të tabelës nr.2 më poshtë:

Tabela 1. Taksa mbi tokën bujqësore

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës	Vlera e taksës lekë/hektar/vit
Kategoria e I	2800
Kategoria e II	2100
Kategoria e III	1400
Kategoria e IV	1350
Kategoria e V	1250
Kategoria e VI	1200
Kategoria e VII-X	1100

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga Sektori i Menaxhimit të Tokës Bujqësore Përrjashtimet nga pagesa e taksës së tokës.

Të përjashtohen nga pagesa e taksës së tokës bujqësore familjet që kanë në perberje të tyre persona me aftësi të kufizuara (PAK),invalid pune e lufte,paraplegjike e tetraplegjike , verbëri si dhe të semure mendore.Përjashtimi nga taksa të bëhet vetëm për personin e semure duke përpjestuar sasinë e tokës së përfituar me anëtarët e familjes në momentin e përfitimit të tokës.

Perjashtohen nga taksa e tokës bujqësore ato familje të cilat toka bujqësore ka pesuar dëme nga erozioni,permbytjet,shkarjet etj.Per të cilat vërtetohet me dokumentacion ngjarja e ndodhur dhe sipërfaqja e dëmtuar.

Perjashtohen nga taksa e tokës bujqësore ato familje ku sipërfaqja e tokës bujqësore është ndryshuar si pasojë e ndertimeve si rrugë,ndertesa publike,ujësjellëse etj. Per të cilat vërtetohet me dokumentacion ngjarja e ndodhur dhe sipërfaqja e dëmtuar apo tjetërsuar.

Gjithashtu përjashtohen nga pagimi i kësaj takse familjet për të cilat këshilli komunave dhe Bashkisë ka vendosur përjashtimin nga pagesa e taksave dhe tarifave vendore.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

1.3.TAKSA MBI TRUALLIN.

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të datës 17.12.2015.

“Truall”, është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në hektar, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Në ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të datës 17.12.2015 për Bashkinë Mallakastër është 2 800 (Dymijë e tetëqind) lekë/hektar/vit për familjet dhe 15 lekë/m² për bizneset.

E kthyer në lekë/m² paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 2.Taksa mbi truallin

Nr.	Lloji i taksës	Njësia	Vlera e taksës lekë/ m ² /vit
1	Taksë mbi truallin për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës lekë/m ² /vit	0.28
2	Taksë mbi truallin për qëllime biznesi	Vlera e taksës lekë/m ² /vit	15

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

2.TAKSA E TABELËS

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të datës 17.12.2015.

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:

i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga germa të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo piktuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një table identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo

në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Mallakastër.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Mallakastër është si më poshtë vijon :

Tabela nr.3.Taksa e tabelës

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matëse	Niveli i taksës
1	Taksë tabele për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo,brënda territorit ,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri në 2 m2	Lekë/m2/vit	0
b	- Mbi 2m2 deri 10 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	7 000
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	11 500
	-elektronike	Lekë/m2/vit	15 000
C	- Mbi 10m2 deri 20 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	9 775
	-elektronike	Lekë/m2/vit	12 750
ç	- Mbi 20m2 deri 40 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	6 325
	-elektronike	Lekë/m2/vit	8 250
d	- Mbi 40 m2		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	4 600
	-elektronike	Lekë/m2/vit	6 000
2	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	-tabela identifikuese	Lekë/m2/vit	120
3	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	-e thjeshtë (me /pa ndriçim)	Lekë/m2/vit	13 500
	-elektronike	Lekë/m2/vit	27 000
4	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura , panaire, spektakle, stenda reklamuese,banderola ,etj...		
	-të gjitha llojet e përmasave	Lekë/m2/ditë	1 000

Detyrimi dhe këstet e pagesës:

Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1 dhe 2 është vjetor.

- Për "kategorinë 1 ,2 dhe 3" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet kesti i pare brenda datës **30 Prill** dhe kesti i dytë brenda dates **31 Gusht** të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës **30 Prill**, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi.

- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKB.

- Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.

- Për "kategorinë 4" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Mallakastër dhe paguhet menjëherë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së reklamës është Drejtoria Ekonomike me Zyrën e Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

3.TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME.

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të datës 17.12.2015.

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
- Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.
- Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre, dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind.
- Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive Të Paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Mallakastër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Tabela nr.4.Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë.

Nr	Kategoria	Njësia matjes	Niveli i taksës
1	Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	300
3	Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Përrjashtime nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përrjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

4.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore",i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të datës 17.12.2015,neni 27.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është si vijon:

1. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 % të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut,

sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

2. Për Bashkinë Mallakastër taksa e ndikimit në infrastrukturë për çfarëdo lloj ndërtimi është:

3 % për Njësinë Administrative Ballsh,

2 % për të gjitha Njësitë Administrative të tjera.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit ose preventivën e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

3. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 % e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivën e investimit.
4. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 % e vlerës së investimit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Pagesa e taksave do të kryhet pas miratimit të vendimit dhe para zbardhjes së tij.

- ✓ Përfshihen nga pagesa e kësaj takse, investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese me 5 vje, status special" sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit
- ✓ Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të **certifikuara si "agroturizëm"**, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit
- ✓ Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë Mallakastër.

5.TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me ligjin nr.142/2015 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të datës 17.12.2015.

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)"Bujtinë";b)"Fjetinë" (Hostel); c)"Kamping"; ç)"Hotel"; d)"Motel"; dh)"Resort"; e)"Qendër kurative"; ë)"Fjetjedhe mëngjes" (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: "Bujtinë"Standard, "Fjetinë"Standard, Komfort; "Kamping"Standard, "Hotel" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Motel"Standard, Komfort, Superior; "Resort" tre yje, katër yje, pesë yje; "Qendër kurative" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Fjetje dhe mëngjes" (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.6.Taksa e fjetjes në hotel.

Nr.	Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
1	Hotel me 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105
2	Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

Detyrimi dhe këstet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli.

Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

KAPITULLI II : TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto

njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.

2. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

- a) tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave;
- b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;
- c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet;
- ç) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit;
- d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve;
- dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj;
- e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave si më poshtë:

- a) për zënien e hapësirës në zonat publike ose para mjediseve të biznesit, për qëllime biznesi, përfshirë këtu tavolinat jashtë për bare dhe restorante;
- b) për përdorimin e tabelave të reklamave;
- c) për zënien e hapësirave të parkimit për mjetet motorike;
- ç) për zënien e sipërfaqeve për kamping, ngritje tendash dhe mjeteve të tjera për përdorim të përkohshëm;
- d) për zënien e brigjeve ujore për biznes dhe qëllime të tjera;
- dh) për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve e të mjeteve të lundrimit dhe objekteve të tjera në det, lumenj ose liqene;
- e) për mbajtjen dhe përdorimin e barkave e të platformave pluskuese, përjashtuar këtu barkat që përdoren nga organizatat e angazhuara në mirëmbajtjen dhe shënjimin e rrugëve ujore;
- ë) për restorante dhe mjedise të tjera ushqimi dhe argëtimi pranë detit, lumenjve ose liqeneve;
- f) për zënien e hapësirës publike për rulotë dhe trajlerë, përveç automjeteve bujqësore dhe makinerive bujqësore;
- g) për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit;
- gj) tarifa të tjera, që mund të vendosen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Në vendosjen e këtyre e tarifave, si rregull, ndiqen këto parime dhe kritere:

- a) vendndodhja (zona) ku ushtrohet veprimtaria, për të cilën vendoset tarifa;
- b) karakteristika të tjera objektive dalluese të personave fizikë ose juridikë që zënë hapësirën publike.

3. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton, me vendim, nivelin e tarifave vendore, zonat dhe përdoruesit, përfshirë përjashtimet e lehtësimet, afatet dhe metodat e pagesës së tarifave.

II.a. TARIFAT VENDORE PËR BIZNESIN ME QARKULLIM DERI NË 14 MILIONË LEKË

II.a.I.TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TE MBETURINAVE

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore",i ndryshuar,neni 35, dhe ligji nr.68/2017,"Për financat e vetqeverisjes vendore"neni 17 i tij

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Mallakastër dhe njësisive të saj administrative.

Detyrimit të pageses së kësaj tarife i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në zonat dhe territorin në të cilin ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabela nr.7.Tarifa e pastrimit për biznesin e vogël.

Nr.	Lloji i aktivitetit	Niveli i tarifës
I	Për çdo njësi tregtare me pakicë (ku përfshihen të gjitha pikat fikse)	
1	Ushqimore,bulmetore,fruta-perime dyqane mishi e peshku.	8.000
2	Ushqimore,bulmetore,fruta-perime dyqane mishi e peshku me xhiro vjetore -- 14 milione lekë	15.000
3	Konfeksionesh, (metrazhe e veshje)	6.000
4	Artikuj të ndryshëm industrial,ene guzhine etj.	8.000
5	Hidrosanitare, paisje elektro-shtëpiake,shitje mobiljesh,bojera etj...	10.000
6	Bombla gazi, rimbushje të bomblave të gazit.	16.000
7	Tregtim dhe bluarje kafeje	5.000
8	Bizhuteri, floriri e materiale të tjera të çmuara,librari ,artikuj artistik	10.000
9	Restorante	25.000
10	Bar-bufe dhe kafene nga 1 deri në 10 tavolina.	10.000
11	Bar-bufe dhe kafene mbi 10 tavolina.	15.000
12	Tregti artikuj te ndryshem ne kioske	4.000
13	Për të gjitha njësit e tjera tregtare me pakicë të cilat nuk janë përmendur më sipër propozohet.	4000
14	Tregti materiale ndërtimi	16.000
15	Pika grumbullimi skrapit e grumbullime të tjera	30.000
16	Fast-food ,mëngjesore ,byrektore,piceri	12.000
17	Tregti artikuj elektronik servise etj..	6.000
18	Shites te veglave te punes dhe pajisjeve bujqesore	10.000
19	Tregtim i imputeve bujqesore ,farera,plehra kimik,miell etj...	10 000
20	Farmacit, bujqesore dhe veterinare	10.000
I.1	Për çdo njësi tregtare shitje me shumicë propozohet.	12.000
II	Për çdo njësi shërbimi	
1	Riparim të paisjeve elektro-shtëpiake	5.000
2	Internet ,bilardo dhe lojera elktronike per femije	5.000
3	Lavazho	10.000
4	Gomisteri	15.000
5	Pikat e shërbimit te makinave (serviset)	15.000
6	Autoshkolla	8.000
7	Exchange	8.000
8	Palester,kalceto	10.000
9	Rrobaqepsi	5.000
10	Kompani sigurimi,biletari	10.000

BASHKIA MALLAKASTËR PAKETA FISKALE 2026

Nr.	Lloji i aktivitetit	Niveli i tarifës
11	Callcenter	20.000
12	Germime dheu, autobote pastrimi etj.	10.000
13	Shërbime funerale	10.000
14	Kancelari, fotokopje ,videotek	5.000
15	Parukeri ,berberane	5.000
16	Kurse gjuhë e huaj & të tjera profesionale, arsimore, kulturore, sportive	8.000
17	Kopshtet jo publike	5.000
18	Pastrim kimik, kënd lojrash për fëmijë.	5.000
19	Tregje private industrial dhe ushqimor	10.000
20	Orëndreqës, këpucar e të tjera artizanale	4.000
21	Programues web developer, graphic design	6.000
22	Dhënie makina me qera	5.000
23	Bujtina ,Kamping	10.000
24	Hoteleri	15.000
25	Agroturizëm	25.000
26	Agroferma	20.000
27	Për të gjitha njësitë e tjera shërbimi të cilat nuk janë përmendur më sipër.	5.000
III	Për çdo njësi prodhimi propozohen	
1	Përpunim duralumimi, druri, metalesh, tapiceri, mermeri, guri etj..	20.000
2	Pastiçeri	12.000
3	Prodhime me karakter ushqimor, pije alkoolike dhe freskuese	20.000
4	Furra buke	10.000
5	Prodhim gëlqere	10.000
6	Baxho	10.000
7	Kultivim fidan	8.000
8	Fabrikë mielli	20.000
9	Fabrikë vaji, konservim fruta-perime	20.000
10	Prodhim dhe shitje fidanesh	10.000
IV	Për çdo njësi shërbimi e tregtimi për profesionet e lira	
1	Klinika dentare, veterinare, mjek, laborant.	10.000
2	Noter, avokat, përkthyes, inxhinier ,kontabilist, topograf	10.000
3	Saladator, tornitor, hidraulik elektrikist, dhe punime ne ndertim	8.000
4	Për të gjitha njësit e tjera profesione të lira të cilat nuk janë përmendur më sipër	8.000
V	AMBULANT	3.000
VI	Transport pasagjerësh	
1	Automjete deri në 5 vende	5.000
2	Automjete 6 deri në 9 vende	8.000
3	Automjete 10 deri në 25 vende	10.000
4	Automjete 26 deri në 42 vende	15.000
5	Automjete mbi 42 vende	20.000
VI.1	Transport mallrash	
1	Automjete deri në 2 ton	5.000
2	Automjete mbi 2 deri në 5 ton	7.000
3	Automjete mbi 5 deri në 10 ton	10.000

Nr.	Lloji i aktivitetit	Niveli i tarifës
4	Automjete mbi 10 deri në 16 ton	15.000
5	Automjete mbi 16 ton	20.000
VII	Agjensi transporti me xhiro nën 14.000.000 lekë	15.000

Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor.

- Për subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit.

Afati i shlyerjes së detyrimit është brenda datës **30 Prill** kesti i pare dhe kesti i dyte deri **31 Gusht** të vitit fiskal.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës se Pastrimit dhe të Largimit të Mbeturinave për kategorinë e sipërpërmendur është Zyra e Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër

II.a.2.Tarifa e gjelbërimit .

- Për të gjitha ato subjektet biznes i vogël tarifa e ndriçimit tarifa e gjelbërimit është **3 000 lekë** për çdo njësi tregtare,shërbimi, prodhimi etj.

Pagesa për tarifën e gjelberimit është detyrim vjetor.

- Per subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit në QKR (Qendra Kombëtare e Rregjistrimit) .

Afati i shlyerjes së detyrimit është brenda datës **30 Prill** kesti i pare dhe kesti i dyte deri **31 Gusht** të vitit fiskal.

Për fabrikat e vajit afati i pageses do të jetë data **10 Dhjetor**.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës se Pastrimit dhe te Largimit te Mbeturinave për kategorinë e sipërpërmendur është Zyra e Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër

II.a.3.Tarifa e ndriçimit .

- Për të gjitha ato subjektet biznes i vogël tarifa e ndriçimit është **3 000 lekë** për çdo njësi tregtare,shërbimi, prodhimi etj.

Pagesa për tarifën e ndriçimit është detyrim vjetor.

- Per subjektet e regjistruara rishtazi detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit në QKR (Qendra Kombëtare e Rregjistrimit) .

Detyrimit të pageses se kesaj tarifave i nenshtrohen te gjithe subjektet ku ofrohet sherbimi.

Afati i shlyerjes se detyrimit është brenda **30 ditësh** nga data e rregjistrimit në QKR.

Për fabrikat e vajit afati i pageses do të jetë data **10 Dhjetor**.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së ndriçimit për kategorinë e sipërpermendura është **Spektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër .**

II.b.TARIFAT PËR BIZNESIN ME QARKULLIM MBI 14 MILIONË LEKË

Në biznes i madh do të përfshihen të gjitha bizneset që janë të regjistruar me përgjegjësi tatimore Tatim Fitimi (jo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin). Për saktësimin e përgjegjësiive tatimore zyra e Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër rakordon me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier .

**1. NIVELI I TARIFAVE TË NDRIÇIMIT , GJELBËRIMIT DHE PASTRIMIT
PËR BIZNESIN ME QARKULLIM MBI 14 MILIONË LEKË**

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, dhe ligji nr.68/2017, “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 17 i tij

Detyrimit të pageses së kësaj tarife i nënshtrohen të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në zonat dhe territorin në të cilin ofrohet shërbimi nga Bashkia Mallakastër.

Tabela..Niveli i tarifave te ndricimit ,gjelberimit dhe pastrimit për biznesin e madhë.

NR .	<u>LLOJI I AKTIVITETIT</u>	Niveli i tarifave në Lekë		
		Tarifë ndriçimi lekë në vit	Tarifë gjelbërimi lekë në vit	Tarifë pastrimi lekë në vit
I	• Për çdo njësi ndërtimi			
1	Për subjektet e ndërtimit person fizik	7.000	10.000	30.000
2	Për subjektet e ndërtimit person juridik	10.000	15.000	60.000
II	• Per çdo njësi prodhimi			
1	Për subjekte prodhimi person fizik	7.000	10.000	20.000
2	Prodhim pijesh freskuese,alkolike etj	7.000	10.000	50.000
3	Për subjektet e prodhimit person juridik	10.000	15.000	60.000
4	Prodhim inertesh,asfalto betoni	10.000	15.000	65.000
III	• Për cdo agjensi			
1	Shoqëri sigurimi automjetesh, këmbimet valutore personat fizik e juridik,imobilare etj...	8.000	8.000	15.000
IV	• Shërbime me mjete transporti			
1	Kur veprimtaria klasifikohet shoqëri	8.000	8.000	40.000
2	Agjensi transporti (filial)	7.000	7.000	20.000
3	Transport mallrash e materialesh	7.000	7.000	25.000
V	• Për çdo njësi Tregëtie			
1	Lëndë të parë për industrinë	7.000	7.000	60.000
2	Makineri për industrinë, automjete etj.	7.000	7.000	60.000
3	Karburant e lëndë djegëse	8.000	8.000	50.000
4	Import – export i materialeve dhe mjeteve motorike, paisjeve elektro-shtepiake etj	8.000	8.000	60.000
5	Supermarketet	7.000	7.000	50.000
6	Dyqan ushqimore dhe pije freskuese	7.000	7.000	25.000
7	Dyqan mishi	7.000	7.000	30.000
8	Bar-restorante	7.000	7.000	30.000
9	Tregëtim për materiale ndërtimi kur biznesi klasifikohet shoqëri	8.000	8.000	40.000
10	Tregëtim për materiale ndërtimi person fizik	7.000	8.000	20.000
11	Pika grumbullimi skrapi e grumbullime të tjera	7.000	8.000	50.000
12	Farmacë , Mjek, laborant, për personat juridik	7.000	7.000	30.000
13	Farmacë , Mjek, laborant, për personat fizik	6.000	6.000	20.000

NR.	LLOJI I AKTIVITETIT	Niveli i tarifave në Lekë		
		Tarifë ndriçimi lekë në vit	Tarifë gjelbërimi lekë në vit	Tarifë pastrimi lekë në vit
VI	• Për çdo njësi shërbimi			
1	Komplekse sportive	6.000	6.000	30.000
2	Polici private	6.000	6.000	30.000
3	Autoshkolla	6.000	6.000	20.000
4	Servise e autoservise	6.000	6.000	20.000
5	Pastrim kimik	6.000	6.000	30.000
6	Lojra fati dhe llotari sportive	10.000	10.000	50.000
7	Shkolla jo publike	10.000	10.000	50.000
8	Kopshtet jo publike	10.000	10.000	60.000
9	Alb telekomi	10.000	10.000	50.000
10	Posta Shqiptare	10.000	10.000	50.000
11	Tregje privat	10.000	10.000	50.000
12	Bankat	15.000	15.000	70.000
13	Transmetues Valëve televizive (Kabllor)	10.000	10.000	100.000
14	Programues web developer,graphic design	6.000	6.000	15.000
15	Shërbime telefonike mobile Vodafonë, Telekom,One etj.	10.000	100.000	100.000
16	Kontroll dhe kolaudim për enët nën presion	10.000	10.000	25.000
VII	• Fassonerit	10.000	10.000	100.000
VIII	SHOQËRITË E NXJERJES SË NAFTËS			
1	Albpetrol sh.a	50.000	5.600.000	600.000
2	Anio Oil sh.a	-	840.000	300.000
3	Terra Oil Swiss sh.a	-	2.800.000	-
IX	SHOQËRITË NË FUSHËN E ENERGJISË			
1	FSHU	250.000	350.000	50.000
2	OSHEE	250.000	350.000	50.000
3	Shoqëritë e prodhimit të energjisë nga sistemet fotovoltaike			250.000
VIII	Institucionet shtetërore	25.000	10.000	10.000

Për biznesin e madh afati i kryerjes së pagesës është deri më **30 Prill** të vitit fiskal. Pas kësaj date apikohen gjoba dhe kamat vonesa .Tatimpaguesi detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike , dhe masa e kamatëvonësës, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave është ,sektori i Tatim -Taksave .

2.1- Tarifat e Gjelbërimit dhe Pastrimit për shoqëritë e naftës dhe energjisë

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”,i ndryshuar,neni 35, dhe ligji nr.68/2017,“Për financat e vetqeverisjes vendore”neni 17 i tij.

3. TARIFA E NDOTJES

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”,i ndryshuar,neni 35, dhe ligji nr.68/2017,”Për financat e vetqeverisjes vendore”neni 17 i tij

Njësitë e vetqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribueshëm për aktivitetin në fjalë.

Duke parë që ndotja e ajrit,ujit dhe tokës nga aktiviteti i disa lloj bizneseve ka ndikim në jetën e komunitetit, propozojmë për ndotjen që këto subjekte shkaktojnë të tariforen sipas nivelit të paraqitur në tabelën e mëposhtme

Tabela nr.17.Niveli i tarifave të ndotjes

Nr	Lloji i aktivitetit	Tarifa
1	Subjetet e nxjerrjes dhe përpunimit të hidrokarbureve	220 lekë/m ²
2	Pikat e shitjes së gazit të lëngshëm me shumicë	50.000 lekë
3	Pikat e shitjes së gazit të lëngshëm me pakice	10.000 lekë
4	Për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e shfrytëzimit të inerteve.	100.000 lekë
5	Për fabrikat e vajit të ullirit	30.000 lekë
6	Subjekte te përpunimit të qumështit (baxho)	30.000 lekë
7	Furrë buke	10.000 lekë

Ngarkohet zyra e urbanistikës dhe Sektori i Tatim Taksave për verifikimin dhe saktësimin e sipërfaqeve të subjekteve që tarifohen sipas nivelit tarifës të tabelës së mësipërme.

Kjo taksë është vjetore dhe afati për të paguar detyrimin është deri në datën **30 Prill**.

Për fabrikat e vajit afati i pageses do të jetë data **10 Dhjetor**.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave është ,sektori i Tatim -Taksave .

4.TARIFAT PËR FAMILJE

Baza ligjore : Ligji nr.9632, dt.30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”,i ndryshuar,neni 35, dhe ligji nr.68/2017,”Për financat e vetqeverisjes vendore”neni 17 i tij

Këto tarifa do të aplikohen në njësitë dhe nënndarjet e tyre ku ofrohen shërbimet nga Bashkia Mallakastër.Detyrimi është vjetor.

Zyra e Tatim Taksave duhet të pajisi çdo familje me librezën e pagesës së tarifave nga familjet.

Tabela nr. 16. Niveli i tarifave për familje aty ku ofrohet shërbimi.

Nr	Njësia Administrative	Lloji i tarifës në lekë/familje/vit		
		Tarifë pastrimi	Tarifë gjelbërimi	Tarifë ndriçimi
1	Njësia Ballsh	2.000 Lekë/vit	500 Lekë/vit	1.000 Lekë/vit
2	Njësia Qendër	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
3	Njësia Aranitas	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
4	Njësia Hekal	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
5	Njësia Greshicë	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
6	Njësia Fratar	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
7	Njësia Kutë	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
8	Njësia Selitë	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit
9	Njësia Ngraçan	1.000 Lekë/vit	250 Lekë/vit	500 Lekë/vit

Për këto tarifa afati i kryerjes së pagesës nga familjarët deri më **31 Dhjetor**.

Ngarkohet Drejtoria Ekonomike ,Sektori i Tatim Taksave per llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit per tarifën e pastrimit,gjelbërimit dhe ndriçimit për familjet.Për pagesat pas datës 31 Dhjetor do të

aplikohet penaliteti prej ,0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike , dhe masa e kamatëvonesës, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave është ,sektori i Tatim -Taksave ,dhe agjentit të taksave Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime sh.a Fier.

Përrjashtime nga tarifat familjare

<ul style="list-style-type: none"> • Përrjashtohen nga tarifa e pastrimit, gjelberimit dhe ndricimit këto kategori: 	
Për popullatën	
1. Familjet e invalidëve të punës e të luftës	0 lekë
2. Familjet që kanë në përbërje të tyre të paaftë (PAK)	0 lekë
3. Familjet që kanë në përbërje të tyre të verbër.	0 lekë
4. Familjet që kanë në përberje të tyre parablegjik dhe tetraplegjik	0 lekë
5. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	0 lekë
6. Kryefamiljaret pensionist te vetmuar.	0 lekë
7. Familjet që kanë statusin e të përndjekurve politik	0 lekë
8. Familjet e veteraneve te luftes	0 lekë
9. Dhe çdo familje për të cilat është marr vendim nga këshilli Bashkiak për përrjashtimin nga tarifat vendore .	0 lekë
10. Familjet të cilat figurojnë me harxhim 0 (zero) në faturën e ujësjellës kanalizime të paktën për gjatë muajit paraardhës të përrjashtohet nga tarifat familjare	0 lekë

4. TARIFA PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT.

Bazuar ne ligjin nr.8450,datë 24.02.1999 “Për përrpunimin ,transportimin dhe tregëtimin e naftës ,gazit dhe nënprodukteve të tyre”,i ndryshuar,si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e liçensave për tregëtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të saj”,Bashkia Mallakastër jep autorizime për personat juridik dhe fizikë,të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e lëndëve djegëse për automjete (pikat e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë mallakastër.

Liçensat jepen nga Bashkia Mallakastër për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë përrsëritje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë.

- Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçensave për stacionet e shitjes së karburatneve ,gazit të lëngshëm të naftës për automjetet, dhe vajra lubrifikantë të jetë **1 000 000** lekë.
- Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçensave për njësit e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm ,që ushtrojë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë të jetë **100 000** lekë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria Ekonomike me Zyrën e Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

5. TARIFA PËR PËRDORIMIN E TREGJEVE TE LIRA

Tabela nr.18.Tarifa për përdorimin e tregjeve të lira.

1	Tarifë për përdorim të tregut të lirë të qytetit Ballsh a)Për tregëtim mallra industriale . b)Për tregëtim mallra ushqimore, fruta – perime, vezë . c)Për tregëtim mish, peshk	50 leke/m2 ne dite 50 leke/m2 ne dite 200 leke/m2 / dite
2	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	30 leke/m2 ne dite

6.TARIFAT E PARKIMIT

Tabela nr.19.Niveli i tarifave të parkimit

NR	Emërtimi	Vlera e tarifës
1	Për autovetura të liçensuara për taksí (me vende qëndrimi të përcaktuara)	
	-autovetura taksi 8 + 1	5.000 lekë / vit
	- autovetura taksi 4 + 1	3.000 lekë / vit
2	Për autobuza të shoqërive të transportit (pa parkim të rezervuar	
	- autobusë deri ne 30 vende	6.000 lekë / vit
	- autobusë mbi 30 vende	8.000 lekë / vit
3	Per mjete transporti (pa parkim te rezervuar)	
	- automjet transport malli deri 3,5 ton	2.000 lekë / vit
	- automjet transport malli nga 3,5 ton deri ne 8 ton	5.000 lekë / vit
	- automjet transport malli nga 8 ton deri ne 14 ton	7.000 lekë / vit
	- automjet transport malli mbi 14 ton	10.000 lekë / vit

NR	Emërtimi	Vlera e tarifës
4	Taksë parkimi të rezervuar	20.000 lekë / vit

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave se parkimit është Zyra e Transportit e ndihmuar nga Zyra e Shërbimeve.

7. TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË MALLRAVE DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI

Tabela nr.21. Niveli i tarifave të licensimit të transportit të mallrave.

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matjes	Tarifa në lekë Afati	
			Një vjeçar	Tre vjeçar
I	Transport Mallrash Brenda vendit			
I.	❖ Liçencë për Transport Mallrash për të tretë dhe me qira Brenda Vendit	Për liçensë	8.000	24.000
II.	❖ Çertifikat për Transport Mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.	Për çertifikat	5.000	-
III.	❖ Çertifikat për Transport Mallrash brenda vendit për llogari të vet	Për çertifikat	4.000	-

Struktura që do të merret për vjeljen e tarifave të sipërpërmendura do të jetë Zyra e Transportit.

TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI

Tabela nr.22. Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matjes	Tarifa në lekë Afati	
			Një vjeçar	Pesë vjeçar
1.	TRANSPORT UDHËTARESH BRENDA VENDIT			
I.	❖ Liçensë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta Ndërqytetës të Transportit Rrugor të Udhëtareve Brenda Vendit	Për linjë	13.000	65.000
II.	❖ Liçensë Për kryerjen e shërbimeve të rregullta Qytetës të Transportit Rrugor të Udhëtareve Brenda Vendit	Për linjë	11.000	55.000
III.	❖ Liçensë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta Rrethqytetës të Transportit Rrugor të Udhëtareve Brenda Vendit	Për linjë	6.000	30.000
IV.	❖ Certifikatë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta Ndërqytetës	Për mjet	8.000	-

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Tarifa në lekë Afati	
			Një vjeçar	Pesë vjeçar
V.	❖ Certifikatë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta Qytetës	Per mjet	6.000	-
VI.	❖ Certifikatë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta Rrethqytetës	Per mjet	4.000	-
VII.	❖ Licensë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta të Specializuara të Transportit Rrugor të Udhëtareve Brenda Vendit	Për linjë	11.000	55.000
VIII.	❖ Licensë Për kryerjen e shërbimeve vajtje - ardhje të Transportit Rrugor të Udhëtareve Brenda Vendit	Për linjë	11.000	55.000
IX.	❖ Certifikatë Për kryerjen e shërbimeve të Rregullta të Specializuara	Per mjet	6.000	
X.	❖ Certifikatë Për kryerjen e shërbimeve vajtje - ardhje	Per mjet	6.000	
XI.	❖ Certifikatë e leshuar për operacione të transportit të udhëtareve për llogari të vetë Brenda Vendit	Per mjet	8.000	
2.	SHËRBIME TRANSPORTI			
I.	❖ Licensë për Agjensi Transport Udhëtarësh dhe Taksi Brënda Vendit	Për licensë	-	20.000
II.	❖ Lidhje kontrate midis shoqërive të transportit të udhëtarëve me miratim të orarit të parkimit të mjeteve nga Bashkia.	Lidhje kontrate	15.000	-
3	❖ Liçencë për Transport Udhëtarësh me Taksi	Per mjet	-	30.000

Struktura që do të merret për vjeljen e tarifave të sipërpërmendura do të jetë Zyra e Transportit.

Tabela nr. 23. Tarifa për shërbimin në fushën e transportit.

Nr.	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Vlera e tar
1	VEPRIMTARI TË TJERA		
I.	Autorizim i përkohshëm një mujor. (Për ndryshim oraresh për shoqëritë e Autobusëve, etj.)	Për autorizim	3.000
II.	Autorizim i përkohshëm një ditor.	Për autorizim	200
III.	Autorizim për leje Parkimi (për ardhjen në ndihmë të subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtarinë brenda juridiksionit të Bashkisë Mallakastër)	Për autorizim	6.000

Shënim : Për dublikate me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmerie, paguhet 30% të vlerës së plotë.

Struktura që do të merret për vjeljen e tarifave të sipërpërmendura do të jetë Zyra e Transportit.

Niveli i tarifave për shërbimet e tjera.

- ▶ Tarifë shërbimi për liçencë, çertifikatë ose autorizim në fushën e transportit 100 lekë
- ▶ Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve mbi 3,5 ton brenda unazës për periudha të përkohshme
 - * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 3,5 T – = 7,5 T 3.000 lekë/vit/mjet ose 250 lekë/muaj/mjet
 - * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 7,5 T – = 12 T 6.000 lekë/vit/mjet ose 500 lekë/muaj/mjet
 - * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 12 T – = 18 T 8.000 lekë/vit/mjet ose 700 lekë/muaj/mjet
 - * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 18 T 12.000 lekë/vit/mjet ose 1.000 lekë/muaj/mjet

Për sa me sipër jemi mbështetur në udhëzimin nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe Procedurat e Lëshimit të Liçencave , Autorizimeve & Çertifikatave “Për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Struktura që do të merret për vjeljen e tarifave të sipërpermendura do të jetë Zyra e Transportit

8. TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Baza e tarifës për zënie e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj, dhe tarifohet për çdo ditë.

Tabela nr.24 .Niveli i tarifës së zënies së hapësirave publike.

Nr	Emërtimi	Niveli i taksës lekë / m ² /ditë
1	Njësia administrative Ballsh	100 lekë / m ² / ditë
2	Njësiti e tjera administrative	50 lekë / m ² / ditë
3	Për këto tarifa tariforet dhe OSHEE,dhe çdo operator tjetër ekonomik i cili zë hapësirën publike në funksion të aktivitetit ekonomik	100 lekë / m ² / ditë

Për përcaktimin e sipërfaqes publike të zënë nga operatorët ekonomik,do të ngihen grupe verifikimi të përbashkëta nga Bashkia Mallakastër dhe përfaqësues të operatoreve ekonomik.

Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike , dhe masa e kamatëvonesës, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për zënie e hapësirave publike është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Mallakastër.

9.Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj.

Baza ligjore : të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, dhe Vendimi nr.607 datë 29.07.2020 “Për tarifën e Shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

Nr	Tarifat e shërbimeve nga SHMZSH	Njësia	Tarifa
1	Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit nga zjarri për projekte të destinuara për banim.	Lekë	
1.1	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi deri në 12 metër.	Lekë	5 000
1.2	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 12 deri në 24 metër.	Lekë	15 000
1.3	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 24 deri në 32 metër.	Lekë	20 000
1.4	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 32 deri në 54 metër.	Lekë	30 000
2	Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.)	Lekë	
2.1	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 500 m ²	Lekë	5 000
2.2	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 1 000 m ²	Lekë	10 000
2.3	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 2000 m ² .	Lekë	20 000
2.4	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 3000 m ² .	Lekë	30 000
2.5	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi mbi 3000 m ²	Lekë	50 000
3	Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përveç objekteve të përcaktuara në pikën 2, të kësaj shtojce, për objektet/aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri.	Lekë	

BASHKIA MALLAKASTËR PAKETA FISKALE 2026

Nr	Tarifat e shërbimeve nga SHMZSH	Njësia	Tarifa
3.1	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje	Lekë	10 000
3.2	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstitit, natyrore/artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme.	Lekë	10 000
3.3	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme	Lekë	10 000
3.4	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë	Lekë	10 000
3.5	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi	Lekë	10 000
4	Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet ku janë të instaluara pajisje nën presion	Lekë	
4.1	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg	Lekë	10 000
4.2	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg	Lekë	15 000
4.3	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 1000 kg	Lekë	20 000
4.4	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m ³	Lekë	10 000
4.5	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiantet për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave	Lekë	10 000

Nr	Tarifat e shërbimeve nga SHMZSH	Njësia	Tarifa
	diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m ³		
4.6	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m ³	Lekë	20 000
4.7	Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m ³	Lekë	20 000
4.8	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m ³ , me pikë të ndezjes mbi 65°C	Lekë	10 000
4.9	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme fikse për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë)	Lekë	20 000
4.10	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miks automobilistik, për përdorim publik dhe privat.	Lekë	20 000
5	Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet e mëposhtme:	Lekë	
5.1	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj., impianeteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj	Lekë	20 000
5.2	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për vend depozitime të mbetjeve të ngurta	Lekë	10 000
5.3	Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për rrugë, hekurudha, ura, tunele	Lekë	20 000
6	Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese	Lekë	5 000

10. TARIFA PËR TAVOLINA JASHTË LOKALIT

